

## Thirrje për Trajner

Shkodër, 13/01/2019


<b>Pozicioni:</b>	<b>Trajnues per aktivitetet sportive</b>
<b>Titulli i projektit:</b>	<b>Arti kundër dhunës</b>
<b>Afati përfundimtar i aplikimit:</b>	<b>dt. 18/01/2019</b>
<b>Periudha e angazhimit:</b>	<b>Dhjetor 2018 – Maj 2019</b>

### 1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

**Projekti** “Arti kundër dhunës” zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë. Projekti “Arti kundër dhunës” përfshin aktivitete të ndryshme, të cilat materializohen në organizimin e mësimeve jo-formale argëtuese me të vegjël të qytetit (arte figurative dhe muzikë), si edhe me organizimin e një sërë aktiviteteve artistiko-sportive (koncerte, ekspozita, teatër, etj.) me të rinjtë dhe shtresat vulnerabel.

### 2. Qëllim i kontratës

Qëllimi i kontratës është organizimi i dy aktiviteteve sportive me të rinjtë e qytetit të Shkodrës.



### **3. Detyrimet e trajnuesit**

Aktiviteti i trajnuesit nis menjëherë pas nënshkimit të kontratës.

Ai është përgjegjës për organizimin e të rinjve dhe realizimin e 2 (dy) aktiviteteve sportive.

Ai raporton pranë shoqatës “Gruaja tek gruaja” (partnerë në projekt) dhe Fondacioni “ARTE”.

Lidhur me çdo problematikë të mundshme, trajnuesi koordinohet me shoqatën “Gruaja tek Gruaja”.  
koordinohet me ta për të gjithë mbarëvajtjen dhe problematikat e mundëshme të aktivitetit.

### **6. Kohëzgjatja e kontratës**

Kontrata nis menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe mbaron në 15 Mars 2019.

### **7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati**

#### **i. të detyrueshme**


- a. Të zotërojë diplomë Bachelor në Sporte ose të ketë kryer kurse formimi në aktivitete sportive;
- b. Të ketë eksperiencë të ngjashme në aktivitete sportive;
- c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
- d. Të jetë i aftë për punë.

#### **ii. të preferueshme**

- a. Të jetë banor në Shkodër.

### **8. Dokumentacioni**

- Letër motivuese ku të shprehet oferta financiare;
- Jetëshkrimi (CV), ku të përfshihen eksperiencat e punës;
- Kopje e ID;



- Fotokopje e Diplomës (nëse ka) ose dokumentacion që vërteton pjesëmarrjen në kurse formimi për sporte;
- Vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore “i aftë për punë”;
- Letër reference nga një punëdhënës i mëparshëm (të specifikohen kontaktet e plota të punëdhënësit);
- Vetëdeklarim gjendjen gjyqësore “i padënuar me vendim të formës së prerë”.

**Kandidatët që shpallen fitues duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kontraktuesi dokumentacioni si më poshtë:**

- Vërtetim banimi;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes shëndetësore

## 9. Pagesa

Pagesa për Trajnerin do të realizohet sipas kontratës që do të lidhet me Fondacionin Arte.

## 10. Aplikimi

Aplikimi duhet të dorëzohet **brenda dt. 18/01/2019**, me email në:

**[fondacioniarte@gmail.com](mailto:fondacioniarte@gmail.com)**

ose

me postë, në adresën zyrtare të Fondacionit ARTE

Rruga e Kavajës, Pallati 223, Shkalla 3, Kati 4, Apartamenti 23, Tiranë

**Përgjigja e rezultateve jepet me email pas tri - pesë ditëve, që nga përfundimi i aplikimit. Kandidati duhet të paraqitet pranë Fondacionit ARTE për nënshkrimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.**